

V E N D I M
Nr.398, datë 24.6.1998

**PËR KONTROLLIN FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË QË KANË MARRË
HUA NGA PUBLIKU I GJERË NËPËRMJET KOMPANISË “COOPERS & LYBRAND”**

Në mbështetje të nenit 1 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëritë tregtare “Vefa Holding”, “Silva”, “Kamberi”, “Cenaj & Co” dhe “M.Leka”, subjekte të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, të cilat janë në proces administrimi, u nënshtrohen edhe kontrollit financiar nga kompania “Coopers & Lybrand”.

2. Kontrolli financiar i shoqërive tregtare, përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të realizohet në dy faza me nga një kohëzgjatje nga 3 muaj secila dhe do të përfshijë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pozicionin financiar të shoqërisë, me detyrimet financiare për t'u paguar, me lëvizjen e parave brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nxjerrjen e detyrimeve debitore dhe të detyrave të tjera të përcaktuara në kontratë.

Kontrolli financiar i librave dhe regjistrave të shoqërisë, bilanceve kontabël apo i dokumenteve të tjera, kryhet nga periudha e fillimit të veprimtarisë së tyre deri në përfundim të administrimit.

3. Kompania “Coopers & Lybrand” me cilësinë e ekspertëve financiarë përbëhet nga këta persona:

Z. Rick Helsby
Z. Richard Coleman
Z. Roger Stanley
Z. Bill Cleghorn
Z. Steve Peters
Z. Keith Boyce
Z. Isabel Ong

4. “Coopers & Lybrand” për të realizuar detyrat në fushën e kontrollit të shoqërive huamarrëse, sipas kontratës bashkëlidhur, e cila është pjesë e pandarë e këtij vendimi, bashkëpunon me kompaninë administratore “Deloitte & Touche”, si dhe merr prej saj gjithë dokumentacionin e nevojshëm që i nevojitet.

5. Sipas kontratës, “Coopers & Lybrand” për të realizuar detyrat në fushën e kontrollit, krahas stafit kryesor që ka në përbërje të tij, përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, aktivizon sipas nevojës dhe ekspertë kontabël të pavarur vendas. Lista e ekspertëve kontabël u vihet në dispozicion nga Grupi Mbikëqyrës duke i dhënë të drejtën personave që sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.178, datë 6.3.1998, janë caktuar në cilësinë e ekspertëve të përkohshëm. Pagesa e stafit lokal përballohet nga “Coopers & Lybrand”.

6. Grupi mbikëqyrës kërkon nga “Coopers & Lybrand” realizimin e sferës së shërbimeve të përcaktuara në kontratë, respektimin e afateve kohore për sigurimin e informacioneve të nevojshme si dhe zbatimin me rigozitet të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.8215, datë

9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave dhe Grupi i Mbikëqyrjes. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano